



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 583 Prot.

Tiranë, më datë 24.10.2025

VENDIM
Nr. 524, datë 24.10.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.10.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e projekt idesë “*Rijetëzimi i kalasë së Rozafës, Shkodër*”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues Atelier 4 dhe zhvillues **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)**, me rekomandimet që në projekt zbatim:
 - Të përfshihet komponenti i muzealizimit brenda muzeut;
 - Të parashikohet një itinerar përreth mureve të kalasë;
 - Të përfshihen ndërhyrje konservuese në strukturat e kalasë;
 - Përmbytja e paneleve informuese të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
 - Të planifikohet që në këtë fazë venddepozitimi i strukturave të përkohshme të propozuara, si dhe mirëmbajtja e tyre;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

